



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.63/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 26.09.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, ZL.Anr.63/2025 datë 25.09.2025.

II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 5.100,00 Euro (pese mijë e njëqind Euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 25.09.2025 ne PZAP-i, është parashtruar ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 25.09.2025 rreth orës 13:00, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë kanë vërejtur se kandidati i subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Komunës së Prishtinës në zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025, z.Përparim Rama, në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Prishtinës të mbajtur më datë 24.09.2025 neth orës 11 ka shfrytëzuar foltoren e Kuvendit Komunal të Prishtinës për të bërë fushatë elektorale për vete dhe subjektin të cilin përfaqëson Lidhjen Demokratike të Kosovës, ashtu që në fjalën e mbajtur para anëtarëve të Kuvendit rreth pikës së rendit të ditës Miratimi

i Projektbuxhetit për vitin 2026 ka deklaruar me sa Vljon: *"Ftoj qytetarët e kryeqytetit të reflektojnë, që me 12 tetor të ua tregojmë vendin secilit asambleist që e ka bllokuar dhe vazhdon ta bllokoj këtë proces demokratik të zhvillimit dhe transformimit të kryeqytetit me votën e tyre, prandaj me 12 tetor urojmë ta kemi një shumicë me të cilën do ta vazhdojmë transformimin e qytetit ashtu siç kemi bërë këto 4 vite. Ju uroj ditë të mirë sot dhe fitore me 12 tetor"*

Mbledhja e lartcekur është transmetuar në platformën Youtube. Provë: Video linku i mbledhjes së Kuvendit Komunal <https://www.youtube.com/live/V41mRiW5E20?si-guQVdRXL5rIN1be8> linku i emisionit (shih nga min. 3:56- 4:35).

Me këtë veprimet e sipërpërmendura, kandidati i lartcekur dhe subjekti politik LDK, kanë shkelur dispozitat e nenit 36 paragrafi 1, i LZP-së duke përdorur resurset shtetërore të nivelit lokal për qëllim të fitimit të votave.

Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë të subjekti politik LDK thekson se duke iu referuar ankesës së paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, lidhur me deklarin e përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës gjatë mbledhjes së Kuvendit Komunal të Prishtinës, dëshirojmë të sqarojmë si vijon: Si Lidhje Demokratike e Kosovës, vlerësojmë se ankesa e tillë është pabazuar. Kjo për faktin se e njëjta nuk përmban ndonjë fakt i cili do ta ndërlidhet veprimin e pretenduar si shkelje të kandidatit tone, sepse kandidati jone është kryetar aktual i Kryeqytetit dhe ka përgjegjësi që buxhetin dhe procedurat tjera të kryej në mënyrë të mirë të qytetareve, pavarësisht fushatës, prandaj fjalët në seancën e thirrur për buxhet nuk kanë qenë të cilat kanë të bëjnë me fushatën por me buxhetin dhe me qytetarin drejtpërdrejtë, sepse dihet që edhe për votimin e buxhetit në bazë të ligjit të buxhetit ka afate, pastaj mos votimi me kohë, gjatë të tere viti të ardhshëm ta bëjë të vështirë planin e punës dhe zhvillimin e projekteve, sepse nëse nuk ndodh ndarja buxhetore në fillim të viti nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pastaj me vone pothuajse po bëhet e pamundur, shtu këtu faktin që ne kemi 9 muaj pa kuvend funksional. Ashtu që qëllimi ka qenë vetëm votimi i buxhetit për të mirën e Kryeqytetit dhe për qytetaret që të arrijnë të marrin shërbimet e tyre dhe ata të mos dëmtohen, sepse buxheti nuk është vetëm i kryetarit Përparim Rama apo LDK, por i qytetarëve dhe të gjithëve partive tjera të cilat pretendojnë ta fitojnë Prishtinën. Deklarimi i kandidatit në fjalë është bërë në kuadër të ushtrimit të detyrës së tij si përfaqësues i qytetarëve në Kuvendin Komunal, në momentin kur është diskutuar për një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme - miratimin e Projektbuxhetit për vitin 2026. Fjalimi ka pasur për qëllim adresimin e problemeve konkrete që burojnë nga mungesa e buxhetit, e cila prek drejtpërdrejt qytetarët e kryeqytetit në fushat jetike të shërbimeve publike dhe sociale, si: mirëmbajtja e infrastrukturës, ofrimi i shërbimeve sociale dhe funksionimi i projekteve komunale. Në asnjë moment ky deklarin nuk ka përbërë thirrje për votim apo fushatë zgjedhore, por është bërë si pjesë e përgjegjësi institucionale për të theksuar rëndësinë e miratimit të buxhetit dhe pasojat që sjell mungesa e tij për qytetarët. Në fjalimin e tij, Kryetari në asnjë moment nuk ka përdorur sloganin zgjedhor, nuk ka bërë thirrje për votim për subjektin LDK apo për veten si kandidat për Kryetar, nuk ka përmendur numrin e partisë në këto zgjedhje (113), dhe nuk ka shfaqur asnjë logo të subjektit në ato ambiente. E gjithë

kjo është zhvilluar brenda rrethanave dhe kushteve të lejuara ligjore, pasi as Ligji për Zgjedhjet Lokale — për të cilin "mutatis mutandis" zbatohen dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme - nuk kufizon veprime apo deklarata deri në atë masë sa ta bëjnë të pamundur një fjalim. Prandaj, mbi bazën e sa më sipër, ankesa e subjektit LVV është e pabazuar. Nëse Kryetari Rama, i cili është edhe kandidat për Kryetar nga radhët e LDK-së, do të bënte thirrje specifike për votim për subjektin, duke përmendur sloganin dhe numrin e partisë, pra duke bërë fushatë klasike e specifike, atëherë do të ishte tjetër gjë; por këtë nuk e ka bërë në asnjë moment të fjalimit të tij.

Andaj, bazuar në argumentet e sipërsënuara të përgjigjes në Ankesë nr. 63/2025, parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje, shqyrtimit të provave të parashtruara nga palët i propozojmë PZAP-së, që ta nxjerr këtë vendim të refuzohet si e pabazuar, ankesa nr.63/2025 e palës e paraqitur kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik LVV-së, dhe shkresave tjera të lëndës, është vërtetuar se kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për Komunën e Prishtinës, Përparim Rama, duke shfrytëzuar pozitën publike e me qëllim të përfitimit të votave ashtu që në fjalën e mbajtur para anëtarëve të Kuvendit rreth pikës së rendit të ditës Miratimi i Projektbuxhetit për vitin 2026 nder të tjera ka deklaruar: *"Ftoj qytetarët e kryeqytetit të reflektojnë, që me 12 tetor të ua tregojmë vendin secilit asambleist që e ka bllokuar dhe vazhdon ta bllokojë këtë proces demokratik të zhvillimit dhe transformimit të kryeqytetit me votën e tyre, prandaj me 12 tetor urojmë ta kemi një shumicë me të cilën do ta vazhdojmë transformimin e qytetit ashtu siç kemi bërë këto 4 vite. Ju uroj ditë të mirë sot dhe fitore me 12 tetor"*

Bazuar në këtë i njëjti ka shkelur dispozitën e nenit 36 paragrafi 1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyrë apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje"*.

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama ka shfrytëzuar hapësirat e brendshme të komunës së Prishtinës respektivisht ka shfrytëzuar foltoren e kuvendit komunal të Prishtinës, u bene thirrje qytetareve me datën 12 tetor pikërisht për ditën e votimit që të reflektojnë se për kënd duhet të votojnë e me qëllim të krijimit të një shumice në asamble, kete deklarim e bene gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të datës 12 tetori 2025, me qëllim të përfitimit të votave, e duke qene në gare edhe për një mandat për kryetar të Prishtinës.

Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e kandidatit për kryetar të Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama, bien ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të Ligji

Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që i njëjti me këto veprime-kërkesa ndaj qytetarëve të Prishtinës ka pasur qëllim të vetëm përfitimin e votave për të dhe subjektin politik me të cilin ai është kandidat për kryetar të komunës së Prishtinës në zgjedhjet lokale që do të mbahen me 12 tetor 2025.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Paneli me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë për bazë praktikën e PZAP-it, e cila ka vendosur për rastet të ngjashme të fjalëve dhe të veprimeve të tilla të përdorura gjatë fushatës zgjedhore nga ana e Subjekteve Politike, dhe atë vendimin ZL Anr.52/2025 datë 23.09.2025, në të cilin vendim të PZAP-it, i është shqiptuar gjoba subjektit politik LDK për arsye se kandidati i subjektit politik në fjalë, ka kryer shkelje të natyrës së tillë me çka i njëjti ka përsëritur shkelje të ngjashme.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.63/2025 më datën 26.09.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.